



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:272325

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05431440

C.nr.7671/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit A.K nga Prishtina, të cilin e përfaqëson av. F.M nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen juridike, për kompensimin e shujtës ditore dhe shpërblimit jubilar, me datë 11.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërsi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.K , nga Prishtina, DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale për Arsim, që paditësit A.K nga Prishtina, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,109.50€ dhe atë: në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150% të pagës bazë shumën prej 631.50€ si dhe për ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për 239 ditë pune (nga data 01.09.2021 deri me datë 20.11.2022) shumën prej 478.00€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë 07.12.2023 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit A.K , në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 134.00€, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, kundër të paditurës me datë 07.12.2023 ka paraqitur padi për pagesën e shujtës dhe shpërblimit jubilar. Paditësi në padi ka theksuar se është në marrëdhënie pune me të paditurën i punësuar në SHFMU Shkolla e Gjellbërt Prishtinë dhe prej datës 01.09.2021 deri me datë 20.11.2022 ka realizuar 239 ditë të pranisë në punë, ndërsa nga vërtetimi i përvojës së punës vërtetohet fakti se paditësi nga data 25.12.1979 kur ka filluar të punoj si mësues e deri me datë 21.03.2022 ka gjithsej 43 vite përvojë pune. Ka shtuar se baza juridike e kërkesëpadiës gjen mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe ajo e vitit 2021, ku në nenin 35 par. 7 të KKA parashihet se të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim nga 2 euro për secilin ditë pune, ndërsa sa i përket shpërblimit jubilar në nenin 35 paragrafi 8 i KKA parashihet se për 40 vjet të përvojës së punës i takon shpërblimi jubilar në lartësi të 150% të pagës bazë. Andaj mbi bazën e të lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditëses si e bazuar ashtu që të

detyrohet e paditura që paditësit A.K t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,109.5€ dhe atë: në emër të shpërblim jubilar për 40 vite të përvojës së punës në vlerë prej 150% të pagës bazë shumë prej 631.50€ si dhe për ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për 239 ditë pune (nga data 01.09.2021 deri me datë 20.11.2022) shumë prej 478.00€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë duke theksuar se kompensimet e kërkuara në padi nuk janë paraparë me Ligjin e Punës dhe rrjedhimisht e paditura Komuna e Prishtinës gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore linje të veçantë për këto lloje të kompensimit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tersi si të pabazuar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga provat e bashkangjitura në padi, gjykata konstatoi se paditësi A.K , është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjegjësisht është i punësuar në vendin e punës si Mësimdhënës i ciklit të ulët në Shkollën Fillore Shkolla e Gjelbër. Po ashtu, u vërtetua se përgjatë periudhës kohore 01.09.2021 – 20.11.2022, paditësi ka qenë prezent në vendin e punës për 239 ditë pune, ndërsa marrëdhënien e punës e ka themeluar me datë 25.12.1979 ashtu që përvojë të përgjithshme të punës ka gjithsej 43 vite përvojë të punës. Faktet e tilla vërtetohen në bazë të kontratës së punës, me numër të protokollit 14 të dt.01.03.2011, të lidhur mes palëve ndërgjyqëse si dhe vërtetimeve mbi ditët e punës nr.2974/02, të dt.04.12.2023, të lëshuar nga SHFMU “Shkolla e Gjelbër” Prishtinë vërtetimit nr.prot 3068/02 i datës 15.02.2024 lidhur me përvojën e punës së paditësit A.K .

Provave materiale të lartcekura, Gjykata ua fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës nga neni 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK). Kjo për faktin se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore nga data 01.09.2021, e deri me datën 20.11.2022, si dhe kërkesa për shpërblimi jubilar gjen mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit 2056 të datës 18.04.2017 dhe Kontratën Kolektive nr.105, e cila ka hyrë në fuqi nga data 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën nga neni 35 par.7 të Kontratave të lartcekura, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë*

tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim". Ndërsa çështja e shpërblimit jubilar rregullohet me nenin 35 paragrafi 8 pika 8.4 ku parashihet se për 40 vite të përvojës së punës, të punësuarit i takon kompensimi në lartësi prej 150% të një page bazë.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se paditësi është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimeve mes palëve ndërgjyqësve, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet "*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*".

Referuar dispozitave të lartcekura, gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për ushqimin gjatë punës (shujtave) mori për bazë vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë nr.2974/02 të datës 04.12.2023, të lëshuar nga SHFMU "Shkolla e Gjellbër", Prishtinë, nga i cili rezulton se paditësi A.K , për periudhën 01.09.2021 deri 20.11.2022 ka qenë në punë 239 ditë. Prandaj për 239 ditë pune atij i takon kompensimi në lartësi prej 478.00€, (sipas përlllogaritjes 239ditë x 2€ = 478.00€). Ndërsa lidhur me kërkesën për shpërblim jubilar gjykata gjeti se e njëjta është e bazuar për faktin se nga vërtetimi mbi përvojën e punës vërtetohet se paditësi ka themeluar marrëdhënie të punës me datë 25.12.1979, andaj me datë 25.12.2019 i njëjti ka arritur vitin jubilar për 40 vite përvojë të punës, pra në kohën që paditësi ka arritur vitin jubilar për 40 vite përvojë të punës, kontrata kolektive e arsimit e vitit 2017 ka qenë në fuqi pasi që e njëjta gjen zbatim për periudhën 18.04.2017 deri me 21.01.2021. Lidhur me lartësinë e shpërblimit jubilar, nga lista e pagave për paditësin nr.EM00001708 vërtetohet se paditësi ka pagë bazë prej 421€, andaj 150% i pagës bazë rezulton të jet shuma prej 631.50€ të cilën detyrohet e paditura të ia paguaj paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në dy rrethana: fillimisht në faktin që kompensimet e tilla nuk janë paraparë me Ligjin e Punës, si dhe lidhur me faktin se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje kompensimit.

Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vlerëson se e drejta e paditësit për të përfituar kompensimet nga marrëdhënia e punës është paraparë me dispozitat e Kontratës Kolektive, e cila buron pikërisht nga dispozitat e Ligjit të Punës, ku në nenin 3 par.1, pika 1.8 e këtij ligji përcaktohet: "*Kontrata Kolektive - marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas marrëveshjes së arritur*". Në mënyrë më specifike, kushtet lidhur me vlefshmërinë e këtyre Kontratës, janë të përcaktuara me dispozitën e nenit 90 të Ligjit të Punës. Në këtë mënyrë, meqë sipas Kontratës Kolektive të lartcekur, në njërin anë janë paraparë të drejta për njërin palë, e në anën janë marrë përsipër obligime nga pala tjetër, rrjedh se e drejta e paditësit për të përfituar një kompensim të tillë nga marrëdhënia e punës, në mënyrë indirekte derivon nga dispozitat e Ligjit të Punës.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohen pengesë që paditësi t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi

Lidhur me kamatën ligjore prej 8% në vit, Gjykata ka vendosur konform nenit 382 par.1 lidhur me par.2 të LMD-së, duke e obliguar të paditurën që shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit

të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me kamatën ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht datë 07.12.2023, e deri në pagesën definitive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par.1 i LPK-së, dhe të njëjtat i referohen shpenzimeve për përpilim të padisë 104.00 Euro si dhe taksa gjyqësore për padi 30.00 euro, gjithsej 134.00€.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.7671/23, datë 11.03.2024

Gjyqtari,
Ibrahim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.